

Lenda : Informim mbi aktivitetin e shoqerise CMS shpk,per pjesmarrjen e publikut ne lidhje me aplikimin per Leje Mjedisi Tipit B

Per: Agjensine Kombetare te Mjedisit Tirane  
Per Dijeni: Agjensise Rajonale te Mjedisit Qarkut Durres  
Bashkise Durres

1. Shoqeria CMSIndustry shpk kerkon te paiset me leje tipit B sipas titullit i instalimit te kollonës 1 dhe 2 të Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, me Përshkrimin e veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues **ID.10.1** veprimtaria. **Prodhimi i makinerive dhe i paisjeve nqs nuk jane permendur diku tjeter ne kete shtojce** , Kapaiciteti Kufi per lejet e tipit B, **Te gjitha instalimet.**
2. Shoqeria **CMS Industry** shpk eshte themeluar me dt 02.10.2015 dhe eshte regjistruar ne QKB me dt 15.10.2015. Shoqeria CMC Industry shpk eshte e formuar nga kapitali i dy ortakeve Artan Mehmeti me pjesmarrje 70% te kapitalit te shoqerise dhe Florian Mehmeti me pjesmarrje 30 % te kapitalit te shoqerise . Perfaqesuesi me fuqi me te plote te administrimit te shoqerise eshte Artan Mehmeti, ndersa Florian Mehmeti eshte administrator me kufi veprimi deri ne 500.000 lekeetj.  
Per ushtrimin e aktivitetit shoqeria CMS Industry shpk eshte e paisur me numer unik te Identifi-kimit NIPT L52215510A. Aktualisht objekti i aktivitetit i shoqerise eshte Prodhimi i makinerive e paisjeve me konstruksione metalike.
3. Aktiviteti i shoqerrise CMS INDUSTRY shpk zhvillohet ne nje kapanon me numer pasurie 36/28 vol 19 fq.9 me siperfaqe 840 m2 me nje lartesi 7.5 te larte me vendodhje ne Xhafzotaj ne Autostraden Durres Tirane ne zonen kadastrale me nr,3852.

#### **Vendodhja e aktivitetit te subjektit CMS Industry shpk**



**1. X 5129690.13 y 4606209.30    2. X 5129728.19 y 4606227.28**

**3. X 5129697.85 y 4600190.80    4.X 5129739.25 y 4606206.82**

**4. Pershkrimi i aktivitetit** i shoqërisë CMS INDUSTRY shpk zhvillohet në një kanton me sipërfaqe 840 m<sup>2</sup> me një lartësi 7.5 të lartë me vendodhje në Xhafzotaj në Autostradën Durrës-Tiranë në zonën kadastrale me nr,3852.

Në shoqëri janë të punësuar 6 punonjës gjithësejt nga këta tre punonjës janë teknike të cilët merren me prodhimin e konstruksioneve e paisjeve metalike në perpunimin e metaleve, me prerjen bashkëmin, montimin e elementeve metalike sipas porosive të klienteve të cilat përdoren në sektore të ndryshme të ekonomisë por në veçanti në fushën e industrisë .

Me porositjen e klienteve të ndryshë të paisjes apo të konstruksionit fillimisht bëhet studimi i projektit duke e zberthyer atë në elemente të veçanta të përberjes së konstruksionit, mbi këto baze bëhet planifikimi dhe sigurimi i bazës materiale të nevojshme si lëlarina dhe të profileve të dimensioneve të ndryshme që do përdoren për realizimin e projektit të konstruksionit apo të paisjes së porositur. Pastaj bëhet përgatitja e vendit të punës si dhe veglat dhe kontrollin e makinerive që do të përdoren si freza, torno, presa për kthimin e metalit dhe të lëllarinave të saldatriceve.

Pastaj fillon procesi i përgatitjes së elementeve përberës të projektit ( të konstruksionit apo të paisjes së porositur) duke bërë matjet e nevojshme të metaleve dhe të lëllarinave që do përdoren.

Mbas këti procesi fillon procesi i perpunimit të elementeve të projektit nëpër makineritë dhe pasijet duke bërë prejet, kthimin shpim tornim dhe bashkëmin e profileve dhe të lëllarinave sipas projektit të konstruksionit dhe të paisjes së porositur.

Mbasi përgatiten elemente të veçanta të konstruksionit apo të paisjes së porositur nga ana e klienteve e të ndryshëm fillon procesi i kontrollit të saktësisë së elementeve përberës duke bërë punime axhusterie rregullime përfundimtare si pastrime të sipërfaqeve të ndryshme.

Mbasi përfundimit të këtij procesi fillon procesi i bashkimit të elementeve mekanike të përgatitura të konstruksionit apo të paisjes së porositur sipas mënyrës dhe kushteve teknike të paraqitura në projekt

Mbas këtij procesi kalon në procesin e kontrollit të montimit dhe të saktësisë së montimit duke kontrolluar me projektin e porositur.

Mbas këti procesi bëhet kolaudimi përfundimtare i paisjes apo të konstruksionit të porositur.

Pastaj konstruksioni i përfunduar dorëzohet me dokumentin e garancisë dhe kushtet dhe rregullat e sigurimit teknik të përdorimit të paisjes .

Procesi i punës në këto kanton, nuk kërkon përdorim të preparative kimike apo të materialeve shtesë si dhe ujë teknologjik, në këto aktivitet kryhen punë mekanike në ambient të mbyllur.

Perpunimi i profileve metalike bëhet nëpërmjet makinerive që ndodhen në shoqërinë CMS Industry

#### **5.Përmbledhje jo teknike e Instalimit**

Thëksojmë se aktiviteti i shoqërisë CMC Industry shpk është instalim ekzistues, prqë nuk është instalim i ri dhe për rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me një përmbledhje të raportit jo teknik të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

**6.Konsultime nderkufiatre kur kerkohet sipas legjilacionit ne kufi** . Lidhur me kete pike te iformacionit aktiviteti I shoqerise CMS Industry shpk nuk zhvillohet ne nje zone kufitare dhe per rrjedhoje nuk kemi te bejme me pjesmarrjen e publikut ne konsultime nderkufitare.

7. Autoriteti Vendimarrës për dhenien e e aktit të miratimit të lejes së mjedisit procedurat dhe afate që dote të ndiqen.

Mbeshtetur në ligjin nr. 10448 dt 14.07 2011 “ Për lejet e Mjedisit” autoriteti për lejet e mjedisit ku aplikohet dhe leshohet leja e mjedist e tipit A, B dhe C është Qendra Kombëtare e Biznesit.

Në lidhje me procedurat dhe afatet e marrjes së lejes së mjedist janë përcaktuar në VKM nr.,419 dt 25.96.2014 kreu III.

8.Adresa: Agjensia Kombëtare e Mjedisit ( AKM) ,Rr. “Sami Frasheri”Nr.4 Tirane,  
Tel & Fax 042 371 237 [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al) , e-mail: [info@akm.gov.al](mailto:info@akm.gov.al)

CMS Industry shpk  
Administratori  
Artan Mehmeti

**CMS INDUSTRY SHPK**  
AUTOSTRADA DR-TR  
RRUGA E FLLAKES XHAFZOTAJ  
DURRES ALBANIA  
NIPT/NUIS. L52215510A